



Prishtinë, 06.04.2009
Kodi i ZRRE-së:V_169_2009

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 15.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat e nenit 4 të Licencës për shpërndarje të ngrohjes qendrore dhënë NQ Gjakova SH.A.
3. Kërkesën e NQ Gjakova SH.A për miratimin e Kodit të Matjes,

Në mbledhjen e mbajtur më 01.04.2009 nxori këtë:

VENDIM

I. APROVOHET Kodi i Matjes i NQ Gjakova SH.A.

Arsyetim

1. Bazuar në përgjegjësitë që dalin nga neni 4.1 i Licencës së Shpërndarjes së ngrohjes qendrore dhënë NQ Gjakova SH.A, i licencuari obligohet që të përgatis Kodin e matjes dhe të njëjtin ta dërgojë në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) për aprovim.
2. ZRRE ka pranuar kërkesën e të licencuarit - NQ Gjakova SH.A. për miratim të Kodit të matjes, përmes postës së rregullt dhe postës elektronike.
3. Gjatë analizimit të Kodit, ZRRE ka vlerësuar se i njëjti përmban dispozita të cilat vendosin bazën për matjen komerciale të energjisë termike në tregun e ngrohjes qendrore dhe përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve për sa i përket matjes së energjisë termike për ngrohje.
4. Në përputhje me nenin 4.3 të Licencës së shpërndarjes së ngrohjes qendrore, i licencuari obligohet që pas pranimit të këtij vendimi menjëherë ta publikojë këtë Kod në faqen e tij elektronike zyrtare.
5. Ky vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht . Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbizotërojnë versioni në gjuhën shqipe.
6. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi palët e pakënaqura mund të iniciojnë procedurë gjyqësore në Gjykatën Komunale në Prishtinë brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit.

Bashkangjitur: Versioni i aprovuar i Kodit të Matjes.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar